



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilič - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.06.2025, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Bajram Hashani, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Përf. e KFOR-it dhe drejtorët komunal

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Planifikimi i buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028
4. Shqyrtimi i kërkesës nga zyra për barazi gjinore
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti planifikimin e buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028. Ju i keni pranuar edhe ndryshime që janë bërë në punëtorinë e mbajtur me propozimin e disa asambleistëve të Kuvendit, ata të cilët kanë qenë të pranishëm për shtimin e disa projekteve kapitale për KAB-in, 2026-2028.

Enver Gashi – Ne si grup jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe në Kuvend do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Duke pasë parasysh se ky është dokument kryesor dhe shumë i rëndësishëm për funksionimin e Komunës, ne jemi pro që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në seancë të Kuvendit, ndërsa atje ju lusim që ti kemi njerëzit kompetentë që nëse, kemi këshilla, sugjerime apo vërejtje të trajtohen me kohë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Planifikimit të buxhetit për vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028 me ndryshime.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nr.02-020-01-16156-25, të dt.17.06.2025 nga zyra për barazi gjinore. Besoj se në mbledhjen e Kuvendit do të vjen zyrtarja për barazi gjinore, e cila do të na sqaroj në detaje.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë jemi për që të shkoj në Kuvend dhe në Kuvend të vjen zyrtarja për barazi gjinore, në mënyrë që nëse, dikush ka ndonjë paqartësi të na jepë sqarime.

Sami Ahmeti – Unë sa e kuptoj kërkesa ka të bëjë edhe me implikime financiare të cilat nuk janë të përfshira në këtë kërkesë. Përveç, asaj flet për dhunë në familje, por nuk kemi shifra se në çfarë niveli jemi ne këtu. Ne jemi gjithmonë për atë që të gjithë të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jemi për që kjo pikë të shkoj në seancë megjithatë, duhet të kemi një debat cilësor në kuadër të kësaj pike.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nr.02-020-01-16156-25, të dt.17.06.2025 nga Zyra për barazi gjinore.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se nga Zyra pritëse nuk kemi pranuar asnjë kërkesë për shqyrtim prandaj kalojmë në pikën e radhës.

Pika 6 e rendit të ditës

Labinot Mirena - Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e kulturës te subvencionimet e klubeve, klubi i kalërimit "Mazgiti" nuk është subvencionue dhe deshta me ditë arsyeën pse pasi që ka pasë shumë qytetarë të cilët më kanë pyet për çfarë arsye nuk është subvencionue ky klub.

Mbledhja përfundoi në ora 11:11'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

